

Home > Aktualitet > Plagosja në Fier, shpallet në kërkim 'nipçja' i Ben Qimes bashkë me shokun e tij...

AKTUALITET

Plagosja në Fier, shpallet në kërkim ‘nipçja’ i Ben Qimes bashkë me shokun e tij, pasi qëlluan me armë 34-vjeçarin, arrestohen dy vëzhguesit që panë gjithë sherrin e nuk kallëzuan

Kush është Iliri, i forti i Boriçëve dhe nipçja e Ben Qimes

Zbardhet plagosja e 34-vjeçarit në Fier. Autori Ilir Boriç shpallet në kërkim bashkë me shokun e tij Fatmir Krasniqi. Arrestohen dy ‘vëzhguesit’: Armir Budini dhe Julian Mahmutaj.



Foto ilustruese dhe Ilir Boriçi

5 Nëntor, 2020 12:47

FIER– Zbardhet plagosja e 34-vjeçarit në Fier, **ngjarje e ndodhur dy ditë më parë**. ***Dosja.al*** ka mësuar se autori i ngjarjes është Ilir Boriçi, pjesë e grupit të Boriçëve të Fierit dhe ‘nipçja’ i Ben Qimes. Ai bashkë me bashkëpunëtorin në krim, Fatmir Krasniqin, janë shpallur në kërkim, për ngjarjen e dy ditëve, ndërkohë që në pranga kanë rënë dy persona të tjerë.

Bëhet fjalë për Armir Budinin dhe Juljan Mahmutajn (dënuar më parë për kultivim të bimëve narkotike), të cilët akuzohen për veprën penale “moskallëzim krimi”.

Si nisi sherri i para dy netëve?

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, **Dosja.al**

I plagosuri, 34 vjeç me inicialet M.M., është përfshirë në një debat me Ilir Boricin. Sherri për motive banale por që ende nuk dihen konkretisht ka agravuar dhe Boriçi, ka nxjerrë armën. Në bashkëpunim me Krasniqin, ai e ka qëlluar në këmbë 34-vjeçarin, duke e lënë të plagosur.

Dy të tjerët, Budini dhe Mahmutaj, kanë qenë në vendin e ngjarjes, por kanë fshehur krimin. 34-vjeçari i plagosur ndodhet ende në spital, pasi po merr ndihmën e nevojshme mjekësore. ***Dosja.al*** ka zbardhur edhe të shkuarën e të rrezikshmit Boriçi, i cili ka rënë më shumë se pesë herë në prangat e policisë, por sërish ka fituar lirinë për të trajtuar ujërat e krimit në Fier dhe jo vetëm. Vetëm dy vite më parë, ai u arrestua sepse u kap me dy pistoleta dhe një shpatë në banesë, ndërkohë që SKEDA e tij numëron edhe pesë ngjarje të tjera.

(f.m/dosja.al)

12:47 - **Njoftimi nga Policia**

Njoftimi nga Policia: Zbardhet dhe dokumentohet plagosja me armë zjarri e ndodhur 2 net më parë në Fier. Arrestohen në flagrancë 2 shtetas, për moskallëzim krimi dhe veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës, shpallen në kërkim 2 autorët e dyshuar të plagosjes. Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Fier, në vijim të veprimeve hetimore në kryera për zbardhjen dhe dokumentimin e ngjarjes së ndodhur mbrëmjen e datës 03.11.2020, ku si pasojë mbeti i plagosur lehtë në këmbë me armë zjarri, shtetasi M. M., 34 vjeç, arrestuan në flagrancë shtetasit: A. B., 44 vjeç banues në Fier, për veprën penale “Moskallëzim krimi”; J. M., 36 vjeç, banues në Fier, për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” (I dënuar më parë për kultivim të bimëve narkotike). Gjithashtu u shpallën në kërkim, për veprat penale “Plagosja e lehtë me dashje” e kryer në bashkëpunim dhe “Armëmbajtje pa leje”, shtetasit I. B., 44 vjeç (i dënuar më parë për armëmbajtje pa leje) dhe F. S.(K), banues në Fier, dhe po punohet për kapjen e tyre.Ngjarja ka ndodhur në lagjen “8 Shkurti”, Fier, pas një konflikti për motive të dobëta midis shtetasit I. B. dhe M. M.. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për veprime të mëtejshme procedurale.



ETIKETA:

#armir budini #fatmir krasniqi #Fier #ilir boric #julian mahmutaj #plagoset 34 vjecari ne fier

14

SHARES



Previous article

“E pata të vështirë, kisha ankth”, Sam Smith rrëfen për herë të parë eksperiencën e karantinës

Next article

I shpallur në kërkim për mashtrim, arrestohet 20-vjeçari në Durrës

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo

POSTIME TË NGJASHME

Aktualitet



Plagosi 34-vjeçarin pas sherrit në Fier, kush është Iliri, i forti i Boriçëve dhe nipçja...

Aktualitet



Plagoset me armë zjarri 34-vjeçari në Fier

Ekonomi



Impiant fotovoltaik 50 MW në Fier, dy shoqëri dorëzojnë kërkesën në MIE

Aktualitet



Aksident në Fier, infermieri ‘fluturon’ në ajër me ‘Benz’ dhe kalon në korsinë...

RATECH
PROFESSIONAL SECURITY SYSTEMS



NATURA SIBERICA
ALBANIA
COSMETICS OF WILD HERBS AND FLOWERS

ADRESA: RRUGA BRIGADA E VIII, PERBALLE VILA PALMA
TIRANA, ALBANIA CEL: 067 233 2402



STAY CONNECTED



Facebook

LIKE



Twitter

FOLLOW



Instagram


FOLLOW



Youtube

SUBSCRIBE

LAJMET E FUNDIT



5 Nëntor, 2020 14:27

Oriola Marashi dhe Eros Grezda janë ndarë?!



5 Nëntor, 2020 14:23

Kriza e kromit/ Dhjetra minatorë bojkotojnë punën pasi nuk janë paguar në Bulqizë



5 Nëntor, 2020 14:12

U përurua para disa ditësh/ Shtëpia muze e At Gjergj Fishtës mbetet e ‘kyçur’ pas restaurimit



5 Nëntor, 2020 14:08

Thyerja e masës së sigurisë dhe shitja e lëndëve narkotike, arrestohen 2 shtetas një tjetër procedohet penalisht



Stafi

Drejtore : Enton Abilekaj
Kryeredaktor : Fjola Graçi

Gazetarë :

Kejsi Muça
Riviera Gjyli
Anila Kolgjini
Klea Alushi
Sonila Syla

Florida Mingla
Dezdemona Kolaveri
Alberta Boseta
Izmir Akulli